



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1796 prot.

Shkodër, më 27.01. 2026

**VENDIM
Nr. 9, datë 26.01.2026**

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “SUNNY SCHOOLS”, TË FINANCUAR NGA
FONDACIONI “SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË” (OSFA) DHE BASHKIA
SHKODËR, I CILI PËRFSHIN INSTALIMIN E IMPIANTEVE FOTOVOLTAIKE NË
NDËRTESAT E SHKOLLAVE 9-VJEÇARE PUBLIKE “NDRE MJEDA”, “SALO
HALILI” DHE “NDOC MAZI”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës **26.01.2026**, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”; Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 24895 Prot., datë 04.12.2025, ndërmjet Fondacionit “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” (OSFA) dhe Bashkisë Shkodër; vendimin e Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 84, datë 18.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër”; si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Të miratohet projekti “Sunny Schools”, i financuar nga Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” (OSFA) dhe Bashkia Shkodër, i cili përfshin instalimin e impianteve fotovoltaike në ndërtesat e shkollave 9-vjeçare publike “Ndre Mjeda” dhe “Salo Halili”, sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 24895 Prot., datë 04.12.2025.

2. Vlera e financimit nga Fondacioni OSFA është 21,120 (njëzet e një mijë e njëqind e njëzet) euro për instalimin e impianteve fotovoltaike në ndërtesat e shkollave 9-vjeçare publike “Ndre Mjeda” dhe “Salo Halili”, e konvertuar në lekë në vlerën 2,040,825.6 (dy milion e dyzet mijë e tetëqind e njëzet e pesë presje gjashtë) lekë, sipas kursit të këmbimit të datës 04.12.2025, kur është lidhur marrëveshja. Zbatimi i projektit dhe administrimi i buxhetit do të realizohen nga Fondacioni OSFA, i cili do të menaxhojë procedurat e prokurimit dhe kontraktimin e subjekteve të treta për instalimin e impianteve, në përputhje me standardet teknike të kërkuara.

3. Bashkia Shkodër do të financojë me fondet e veta instalimin e impiantit fotovoltai në ndërtesën e shkollës 9-vjeçare publike “Ndoc Mazi”, në shumën totale 1,662,690 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë, e parashikuar në programin buxhetor AI141 “Arsimi”, në fishën buxhetore P.AI141.Q1.O3.A7, konkretisht:

- 1,566,728 lekë në artikullin 231 – Shpenzime kapitale të trupëzuara;
- 95,962 lekë në artikullin 230 – Shpenzime kapitale të patrupëzuara.

Institucion likuidues do të jetë Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike (DPMOP). Financimi do të përballohet përmes rialokimit të fondeve të trashëguara të vitit 2025, sipas fishës bashkëlidhur.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 28 vota

Vota Pro	28
Vota Kundër	6
Vota Abstenim	3
Zbardhur me datë	27.01.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR
Oltion LULI

